

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6537
E mërkurë, 16 shkurt 2022
çmimi 0.40 €

Shqipëria fillon mandatin në KS të OKB-së, Rama: Historike për shtetin shqiptar



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

SHBA-ja I KËRKON SERBISË TA NJOHË KOSOVËN

FAQE 4-5



Në të gjitha urimet e përfaqësuesve të lartë amerikanë dhe evropianë për Ditën e Shtetësisë së Serbisë, i është kërkuar kësaj arritja e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse me Kosovën. Ata kanë vlerësuar se procesi i dialogut duhet të përfundojë në muajt në vazhdim. Ndërsa sekretari amerikan i shtetit, Anthony Blinken, i ka kërkuar Serbisë që kjo marrëveshje të përqendrohet në njohjen reciproke në mes të dy shteteve. Të njëjtën gjë ia kishte kërkuar më parë edhe presidenti amerikan Joe Biden

AKTUALE



KRYETARI I FERIZAJT VIZITON OBJEKTIN E DJEGUR TË 'VIVA FRESH STORE'-S F.7

NË MINISTRINË E MBROJTJES DHE NË FSK FILLON DHURIMI I GJAKUT F.7

QKUK-SË I DHUROHEN 675 SHITRETËR F.3

EKONOMI



MINISTRIA E BUJQËSISË MBULON 75 PËR QIND TË VLERËS SË PRIMIT PËR SIGURIMET BUJQËSORE F.8

HAJDARI: LIGJI PËR INVESTIMET STRATEGJIKE DO TË OFROJË QASJE TË UNIFIKUAR PËR TË BËRIT BIZNES NË KOSOVË F.8

SPORT



INTERI SFIDON GJASHTË HERË KAMPIONËT E EVROPËS F.10

Dy viktima dhe 373 raste të reja me Covid-19

FAQE 7



ME LIGJIN E RI KURTIT PRITET T'I RRIKET PAGA NGA 1 500 NË 2 280 EURO

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Disa trupa ruse janë larguar nga kufiri me Ukrainën

MOSKË, 15 SHKURT - Ministria ruse e Mbrojtjes ka thënë të martën se disa trupa të pozicionuara afër kufirit me Ukrainën janë duke u kthyer në bazat e tyre pas përfundimit të stërvitjeve, ka raportuar agjencia e lajmeve "Interfax". Sipas saj, stërvitjet e shkallës së gjerë në Rusi do të vazhdojnë. Ende nuk dihet sa trupa janë duke u larguar edhe nëse ky vendim do t'i ulë tensionet. Shtetet e Bashkuara kanë vlerësuar se 130 000 ushtarë gjenden afër kufirit me Ukrainën.

Më 14 shkurt Rusia e ka lënë derën e hapur për më shumë diskutime me qëllim të zgjidhjes së krizës.

Gjatë një takimi televiziv me presidentin rus Vladimir Putin, ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, ka thënë se "gjithmonë ka mundësi" për të arritur marrëveshje me Perëndimin për Ukrainën.

Rusia ka insistuar se nuk ka plane për pushtim por, në të njëjtën kohë, kërkon garanci për çështje të sigurisë në Evropë, përfshirë atë që NATO-ja të mos zgjerohet në shtetet si Ukraina, apo ish-republika tjetër sovjetike, Gjeorgjia.

Në kërkesat e Moskës ndaj Perëndimit përfshihen edhe ato që: NATO-ja t'i japë fund aktivitetit ushtarak në Evropën Lindore dhe t'i tërheqë trupat nga Polonia dhe republikat

baltike, Estonia, Letonia dhe Lituania; dhe Aleanca veriatlantike të mos pozicionojë raketa në shtetet afër apo në kufi me Rusinë.

Shtetet e Bashkuara dhe NATO-ja janë përgjigjur duke thënë se Ukraina ka të drejtë t'i zgjedhë aleatët e vet, mirëpo i kanë ofruar Rosisë mundësinë e negociimit rreth raketave dhe çështjeve të tjera.

Nëse Rusia pushton Ukrainën, kjo nuk do të ishte hera e parë. Rusia ka aneksuar Gadishullin ukrainas të Krimesë më 2014.

Ky vend, po ashtu, mbështet rebelët në konfliktet në rajonet lindore të Ukrainës, në të cilat kanë vdekur rreth 14 000 persona.



Europol godet grupin më të madh shqipfolës të trafikimit të kokainës

HAGË, 15 SHKURT - Agjencia evropiane për bashkëpunim të zbatimit të ligjit (Europol) tha se në një operacion të përbashkët kundër trafikantëve të drogës janë arrestuar 45 persona. Europol tha se ky operacion ishte "goditje nga kriminelëve shqipfolës që kanë vërshuar Evropën me kokainë".

Ky operacion i madh, që është zhvilluar kryesisht në Spanjë dhe Belgjikë, vlerësohet të jetë në kuadër të operacioneve të gjera kundër importit në sasi të mëdha të drogës nga Amerika Latine. "Një operacion ndërkombëtar, me përfshirjen e autoriteteve të sundimit të rendit dhe ligjit në shtatë shtete, ka rezultuar me shpartallimin e njërit prej rrjeteve të trafikimit shqipfolës, më aktivë në Evropë. Të

martën Eurojust dhe Europol mbështetën aksionet në Belgjikë dhe Spanjë, gjatë të cilave u bastisën mbi 80 lokacione dhe 45 të dyshuar u arrestuan", thuhet në njoftimin e kësaj agjencie të Bashkimit Evropian që e ka selinë në Hagë të Holandës.

Dyshohet se të arrestuarit kishin importuar kokainë nga Amerika Latine në disa vende në Evropë, duke organizuar transportin e drogës përmes avionëve, anijeve, makinave e kamionëve dhe kanë udhëhequr tregun e shitjes. Spanja dhe shtetet e tjera të BE-së, sipas Europol-it, janë përdorur si vende për ta fshehur aktivitetin e tyre.

Europol tha se "ky rrjet kriminal i nivelit të lartë ka themeluar një sërë ndërmarrjes në shtete të ndryshme për të pastruar



paratë, përfshirë edhe në Kroaci dhe Spanjë. Pjesëtarët e këtij grupi shpesh kanë udhëtuar në Dubai, Meksikë dhe Kolumbi për t'i aranzhuar bizneset e tyre ilegale, duke përdorur komunikim të koduar

për t'i koordinuar aktivitetet e tyre".

Në këtë aksion kanë marrë pjesë 600 oficerë nga Belgjika, Spanja, Kroacia, Gjermania, Italia, Holanda dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që ka

angazhuar zyrtarë të Byrosë Federale të Hetimeve (FBI).

Operacioni ka nisur më 2018 dhe është një prej më të mëdhenjve që e kanë mbështetur Europol dhe Eurojust.

OBSH bën thirrje për vaksinim më të lartë në Evropën Lindore

GJENEVË, 15 SHKURT - Zyra për Evropë e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) ka bërë thirrje për rritje të përpjekjeve për vaksinim kundër koronavirusit në Evropën Lindore, duke paralajmëruar se "vala" e variantit Omicron po nisat andej. Shefi për Evropën në OBSH, Hans Kluge, ka thënë se në dy javët e fundit rastet me koronavirus janë rritur më shumë se dyfish në gjashtë shtete - Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Gjeorgji, Rusi dhe Ukrainë.

"Siç është pritur, vala e Omicronit

po bartet në lindje", ka thënë Kluge.

Dega e OBSH-së për Evropën krahason 52 shtete, përfshirë disa në Azinë Qendrore. Kluge ka thënë se ritmi i vaksinimit është relativisht i vogël në disa pjesë të këtij rajoni.

Më pak se 40 për qind e personave mbi 60 vjeç janë vaksinuar plotësisht në Bosnje-Hercegovinë, Bullgari, Kirgizi, Ukrainë dhe Uzbekistan.

Ai ka shtuar se në Bullgari, Gjergji dhe Maqedoninë e Veriut më pak se 40 për qind e punëtorëve

shëndetësorë kanë marrë të paktën një dozë të vaksinës kundër Covid-19. Ai ka thënë se duke pasur parasysh shtrirjen e variantit Omicron dhe qarkullimin e variantit Delta në lindje, tani nuk është koha për t'i lehtësuar masat që dihet se funksionojnë në luftim të pandemisë. Sipas tij, në mesin e këtyre masave përfshihet shmangia e ngjarjeve me shumë persona, vendosja e maskës në ambiente të brendshme dhe kryerja e testeve të shpejta për t'i identifikuar sa më herët rastet e infektimit.



Shqipëria fillon mandatin në KS të OKB-së, Rama: Historike për shtetin shqiptar

TI RANË, 15 SHKURT (ER) - Të martën është zhvilluar ceremonia zyrtare e organizuar me rastin e fillimit të mandatit të Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Kryeministri Edi Rama në fjalën e tij është shprehur se anëtarësimi në Këshillin e Sigurimit shënon një tjetër gur themelor në rrugën drejt transformimit për përmbushjen e aspiratave si komb. "Mirëmbërëma të gjithë bashkatdhetarëve! Bashkimi në Këshillin e Sigurimit është historike për Shqipërinë. Shpesh rrota e historisë lëviz në drejtime të çuditshme. Ne i mbajmë sytë kah drita në një drejtim të lirisë, demokracisë, reformave dhe zhvillimit. Bota ka ndryshuar dhe është transformuar në 66 vjetet e fundit. Shumë vende

kanë parë jetët e tyre të ndryshojnë rrënjësisht. Anëtarësimi në Këshillin e Sigurimit është një ngjarje me rëndësi historike për Shqipërinë, që shënon edhe një tjetër gur themelor në rrugën tonë të transformimit për t'i përmbushur aspiratat tona si komb dhe për të kontribuar që ta bëjmë botën një vend më të mirë për ne dhe për të gjithë. Shqipëria ishte një bunker në terr. Për thuajse gjysmë shekulli ajo u zvarrit nën një nga regjimet komuniste më shtypëse në Evropë, që e bëri vendin tonë, më duhet ta them, Korenë e Veriut të Evropës. Diktatura u shkrëmoq falë thirrjes së njerëzve drejt asaj çka për natyrën njerëzore është një nevojë e brendshme: lirisë, barazisë, demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Shumë herë

rrota e historisë lëviz në drejtime të çuditshme", ka thënë Rama, duke shtuar se për ne shqiptarët, zgjimi erdhi mjaft vonë. "Ne i mbajmë sytë kah na thërriste drita dhe qysh atëherë kemi ecur në një drejtim të vetëm, atë të lirisë, demokracisë, shtetit të së drejtës, të drejtave e dinjitetit të njeriut, zhvillimit dhe reformave. Që prej kësaj kohe kërkimi i vendit të merituar në rajon dhe Evropë ka mbetur busulla jonë, edhe në momentet më të mundimshme në rrugën tonë të vështirë drejt një shoqërie të lirë e demokratike, drejt familjes me të cilën duam të bashkohemi, familjes evropiane së cilës i përkasim. Bota ka ndryshuar dhe është transformuar gjatë 76 vjetëve të fundit. Shumë vende e shoqëri kanë parë jetët e tyre të ndryshojnë rrënjësisht, por

mund ta them pa asnjë dyshim se transformimi i Shqipërisë është një prej më mbresëlënësve e më me ndikim, deri në atë pikë sa prirem të bie dakord me miqtë që na thonë se përgjatë tri dekadave të fundit, Shqipëria është transformuar më shumë se gjatë tre shekujve të fundit. Ky është bilanci ynë, për të cilin jemi krenarë dhe duam ta përmirësojmë më tej", ka thënë Rama.

Në fjalën e tij Rama nuk ka lënë pa përmendur Kosovën dhe ish-regjimin e Sllobodan Millosheviqit. "Mënyra jonë e drejtpërdrejtë për të kontribuar në lehtësimin e vuajtjes së atyre në nevojë ka qenë të japim atë çka kemi, kur kemi mundur, kur është dashur ta bëjmë: ua kemi hapur shtëpitë dhe zemrat atyre që kanë nevojë për shpëtim dhe strehë; qofshin ata hebrenjtë

gjatë Holokaustit, kur Shqipëria u bë i vetmi vend që kishte më shumë hebrenj pas luftës sesa përpara saj apo për gjysmë milionë kosovarë, që ikin nga spastrimi etnik i regjimit mizor të Sllobodan Millosheviqit apo mijëra pjesëtarë të MEK-ut, që janë strehuar të sigurt në Shqipëri dhe, me së fundi, mijëra afganë që u arratisën nga reprezaljet e talebanëve. Ne nuk kërkojmë merita për këtë. Ato i takojnë dinjitetit, çdo qenie njerëzore, pavarësisht prej besimeve, fesë, etnisë, gjinisë apo cilitdo orientim. Ky nuk është slogan është praktikë e jetuar. Ne nuk veprojmë sipas këtij kodi nderi sepse mundemi por, thjesht, sepse duhet është pjesë e ndjesisë së asaj që jemi si shqiptarë dhe atë që duam të jenë fëmijët tanë", është shprehur kryeministri Rama.



QKUK-së i dhurohen 675 shtretër

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 SHKURT - Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka marrë pjesë në QKUK me rastin e ceremonisë së pranimit të 675 shtretërve spitalorë nga Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA), në kuadër të Projektit për Zhvillimin e Kapaciteteve Kundër Sëmundjeve Infektive, përfshirë Covid-19. "Pas asistencës teknike të ofruar ndër vite, trajnimit të menaxherëve shëndetësorë në Japoni, dhurimit të terapiës Favipiravir për trajtimin e pacientëve me Covid-19 në fillim të pandemisë, pajisjeve spitalore,

ndihmës në fushatën për vaksinim; spitalet tona po pranojnë një mbështetje të jashtëzakonshme, kësaj radhe, 675 shtretër spitalorë", ka deklaruar ministri Latifi gjatë kësaj ceremonie.

Ai ka theksuar se Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Shëndetësisë është shumë falënderuese për këtë përkrahje, sikurse edhe vetë qytetarët e Kosovës, të cilët te qeveria dhe populli japonez kanë gjetur gjithmonë mbështetje për kërkesa konkrete. "Kontributet si ky do ta kenë ndikimin e drejtpërdrejtë në cilësinë e shërbimeve dhe kujdesit shëndetësor dhe ne ju



falënderojmë edhe një herë për mbështetjen konkrete dhe të vazhdueshme për shëndetësinë tonë", u shpreh Latifi.

I ngarkuari me punë i Ambasadës së Japonisë në

Kosovë, Yamanaka Keisuke, ka theksuar se sigurimi i shtretërve për QKUK është pjesa e dytë e implementimit të projektit që kap vlerën prej 846 000 eurove apo 110 milionë jenëve

japonezë.

Përfaqësues kryesor i Zyrës Ballkanike të Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA), Jiro Takeichi, ka treguar se, bazuar në marrëveshjen me MSh-në/ShSKUK-në, 359 shtretër do të mbesin në QKUK, ndërsa 316 të tjerët do të jenë për gjashtë spitalet e përgjithshme (Prizren, Gjiilan, Ferizaj, Gjakovë, Pejë dhe Mitrovicë). Ai ka thënë se përfituesit kryesorë nga modernizimi i shtretërve spitalorë, vebinare e përcjella lidhur me sëmundjet ngjitëse, përfshirë Covid-19 dhe hulumtimin rreth sektorit shëndetësor do të jenë qytetarët e Kosovës.



ShBA-ja i kërkon Serbisë ta njohë Kosovën

Në të gjitha urimet e përfaqësuesve të lartë amerikanë dhe evropianë për Ditën e Shtetësisë së Serbisë, i është kërkuar kësaj arritja e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse me Kosovën. Ata kanë vlerësuar se procesi i dialogut duhet të përfundojë në muajt në vazhdim. Ndërsa sekretari amerikan i shtetit, Anthony Blinken, i ka kërkuar Serbisë që kjo marrëveshje të përqendrohet në njohjen reciproke në mes të dy shteteve. Të njëjtën gjë ia kishte kërkuar më parë edhe presidenti amerikan Joe Biden

**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 15 SHKURT - Sekretari amerikan i Shtetit, Anthony Blinken, i ka kërkuar Serbisë arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse me Kosovën. Teksa ka uruar Serbinë në Ditën e Shtetësisë, kryediplomati amerikan ka vlerësuar se marrëveshja duhet të përqendrohet në njohjen reciproke në mes të dy shteteve. "Vendet tona kanë ndërtouar lidhje të forta gjatë 140 vjetëve të fundit dhe Shtetet e Bashkuara presin të ndërtojnë një të ardhme edhe më të ndritshme së bashku si partnerë në Evropë dhe në skenën globale. Ne jemi të përkushtuar ta mbështesim synimin e Serbisë për integrimin evropian dhe inkurajojmë normalizimin gjithëpërfshirës të

marrëdhënieve të përqendruara në njohjen reciproke me Kosovën, e cila do të nxisë siguri dhe stabilitet më të madh në rajon", është thënë në njoftimin e Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH). Më tej, në njoftim përmendën bashkëpunimet në mes të dy shteteve. "Partneriteti ynë ekonomik me Serbinë u rrit ndjeshëm në vitin 2021, me investime të reja në sektorët e infrastrukturës, teknologjisë dhe bujqësisë. Ne, gjithashtu, rritëm bashkëpunimin tonë dypalësh të mbrojtjes, duke festuar 15-vjetorin e programit të partneritetit shtetëror, duke mbajtur një stërvitje të rëndësishme dypalëshe ajrore dhe duke kryer konsultime ushtarake dypalëshe të nivelit të lartë", është thënë në njoftimin e DASH-it. Të njëjtën porosi Serbia ka marrë edhe nga presidenti i

Francës, Emmanuel Macron. Në urimin e tij për Ditën e Shtetësisë drejtuar presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, Macron dëshiron që dialogu Kosovë - Serbi të përfundojë në muajt në vazhdim. "Do të vazhdoj ta mbështes dialogun me Prishtinën të ndihmuar nga ndërmjetësimi evropian, me qëllim që të përmbillet marrëveshja e gjithanshme dhe përfundimtare e normalizimit të marrëdhënieve. Shpreh dëshirën që sukseset, në këtë drejtim, të ndodhin në muajt në vijim", është thënë në letrën e Macronit. Sipas një komunikate për medie, Franca dëshiron ta vendosë perspektivën evropiane për Ballkanin Perëndimor gjatë presidencës së saj në unionin evropian, në mënyrë që rajonin ta kthejë në "zonë paqe dhe prosperiteti". Normalizimi i marrëdhënieve

me Kosovën për Serbinë është parakushti i vendosur nga BE-ja për anëtarësimin në unionin evropian.

Ditë më parë edhe presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Joe Biden, i ka kërkuar njohjen e Kosovës, presidentit serb Aleksandër Vuçiq. Në letrën e presidentit amerikan, me rastin e Ditës së Shtetësisë së Serbisë, thuhet se ai pret normalizim të plotë të marrëdhënieve ndërmjet Beogradit e Prishtinës, e që duhet të bazohet në njohjen reciproke. "Më vjen mirë që morët pjesë në Samitin e Demokracisë në dhjetor. Unë ju inkurajoj ju dhe qeverinë tuaj që të vazhdoni të punoni me zell për t'i zbatuar reformat e brendshme të nevojshme për t'i bërë arritjet e demokracisë të disponueshme për të gjithë njerëzit në Serbi. Të njëjtat reforma do të ndihmojnë në garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm, sundimit të ligjit dhe një klime tërheqëse investimi si dhe do t'ju sjellin më afër anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Aspiratat e Serbisë drejt BE-së varen edhe nga progresi drejt normalizimit të plotë të marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe

Prishtinës, i cili, siç e dini, besoj se duhet të bazohet në njohjen reciproke. Shtetet e Bashkuara janë të gatshme t'ju mbështesin në punën me mirëbesim për të arritur këtë qëllim", citohet letra e Bidenit.

Ditë më parë Kosovën dhe Serbinë i ka vizituar përfaqësuesi amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, dhe i dërguari special i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak. Ata i kanë inkurajuar të dyja palët për dialog, duke u bërë thirrje për zbatim të të gjitha marrëveshjeve që janë arritur në këtë proces. Ata kanë bërë me dije se nuk do të imponojnë asnjë marrëveshje apo model të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Më pas, Kosovën dhe Serbinë i ka vizituar edhe emisari britanik për Ballkanin Perëndimor, Stuart Peach, i cili i ka dhënë mbështetje këtij procesi.

Vitin e kaluar kryeministri i Kosovës dhe presidenti i Serbisë janë takuar dy herë në kuadër të dialogut në Bruksel. Së fundi është bërë me dije se BE-ja është duke insistuar për një takim të tretë Kurti - Vuçiq para zgjedhjeve në Serbi.

Me ligjin e ri Kurtit pritet t'i rritet paga nga 1 500 në 2 280 euro

"Epoka e re"

PRISHTINË, 15 SHKURT - Me projektligjin e ri të pagave, i cili është publikuar të martën në versionin online të gazetës "Epokës së re", shefja e shtetit do ta ketë pagën më të lartë prej 2 400 eurove. Kryeministri dhe kryetari i Kuvendit të Kosovës do të paguhet 2 280 euro. Me ligjin e ri kryeministrit Albin Kurti do t'i rritet paga nga 1 500 në 2 280 euro. 2 mijë e 280 euro do ta ketë pagën edhe kryetari i Gjykatës Kushtetuese, ndërkaq nga 2 mijë e 220 euro do të paguhet kryetari i Gjykatës Supreme dhe kryeprokurori i shtetit. Deputeti i Kuvendit do të paguhet 1 920 euro aq sa ministri i qeverisë, ndërkaq shefi i stafit të presidencës do ta ketë pagën 1 560 euro. Zëvendësministri do të paguhet 1 512 euro, komandanti i FSK-së 1 848 euro, kurse mjeku specialist 1 212 euro. Rritje të

pagës do të ketë edhe për kryetarët e komunave të cilët do të paguhet 1 560 euro. Profesori i rregullt do ta ketë pagën 1 488 euro, ndërkaq zjarrfikësit 625 euro. Pagat më të ulëta do të jenë për mësimdhënësit në shkollat e mesme të cilët do të paguhet 588 euro, polici i Kosovës do të paguhet 504 euro, kurse ushtari i FSK-së 480 euro.

Ndaj këtij dokumenti të publikuar në medie kanë reaguar dy ish-kryeministrit e Kosovës, Ramush Haradinaj dhe Avdullah Hoti. Haradinaj ka thënë se rritja e koeficientit dhe zvogëlimi i vlerës monetare të tij është mashtrim ordiner. Ai ka thënë se është e rëndësishme që të ky ligj të rirregullohet. "Rritja e koeficientit, në anën tjetër zvogëlimi i vlerës monetare, është mashtrim ordiner. Është tepër me rëndësi që të rirregullohet Ligji i pagave, por ky ligj nuk duhet të bjerë. Po shoh komente dhe qëndrime të ndryshme të sindikatave, të zyrtarëve institucionale dhe të

autoriteteve politike. Të gjithë në një apo në një mënyrë tjetër po i japin qëndrimet për organizatën buxhetore që përfaqësojnë", ka shkruar ai në "Facebook".

Haradinaj i ka bërë thirrje qeverisë të mos eksperimentojë me këtë ligj, duke thënë se durimi ka kufi. "Vlerësimet të cilat kanë qenë të evidentuara janë të përcaktuara nga Gjykata Kushtetuese. Ato duhet të rregullohen, ndërsa koeficienti dhe vlera e tij jo vetëm se nuk duhet të zvogëlohen, por duhet të rriten në përputhje me rritjen e çmimeve të konsumit. Në këtë vend gjithçka është rritur, përpos pagave që kanë mbetur në vendnumëro! I bëj thirrje qeverisë që të mos eksperimentojë me këtë ligj, sepse durimi ka kufi. Pagat duhet të harmonizohen me shkallën e shtrenjtimit të jetesës e jo që punëtorja kosovare të shndërrohet në kategori sociale!", ka shkruar Haradinaj.

Ndërsa ish-kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se me projektligjin e

Në vitin 2018 Kurti i thoshte Haradinajt se bëri vjedhje kur ia rriti pagën vetes

Më 1 mars të vitit 2018, në një seancë të Kuvendit të Kosovës, kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, e pati quajtur "hajni" vendimin e atëhershëm të kryeministrit Ramush Haradinaj për rritjen e pagës për kryeministrin dhe anëtarët e tjerë të kabinetit qeveritar. "T'ia rrisësh pagën vetit është hajni", kishte thënë Kurti gjatë fjalimit të tij në seancën e Kuvendit në vitin 2018.

Kurti e kishte kritikuar Haradinajn edhe për gjendjen e rëndë ekonomike për shumicën e qytetarëve dhe luksin që politikanët po ia bëjnë vetes. "Edhe me këtë qeveri, sikur më të tjerat, nuk flasim për ekonomi, por vetëm për financa", pati deklaruar Kurti.

ri shkelet parimi bazë i përcaktimit të pagave. Edhe Federata e Sindikatave e Shëndetësisë së Kosovës (FSShK) ka reaguar ndaj këtij projektligji, duke kërkuar nga Qeveria e Kosovës që ta bëjë publik atë, në të kundërtën ka paralajmëruar

trazira.

Ndërsa ministri i Punëve të Brendshme (MPB), Xhelal Sveçla, ka mohuar se ka draft final të Ligjit për pagat e zyrtarëve publikë, ku përfshihen pagat për presidentin, kryeministrin e deri te rekruti i FSK-së.



Dy viktimat dhe 373 raste të reja me Covid-19

PRISHTINË, 15 SHKURT - Kosova ka regjistruar dy viktimat dhe 373 raste të reja me koronavirus, ka njoftuar të martën Ministria e Shëndetësisë (MSH). Rastet e reja dolën pas testimit të 3,139 mostrave, që i bie se 11.88 për qind e të testuarve kanë rezultuar pozitivë me sëmundjen

Covid-19. Sipas njoftimit të MSH-së, që i referohet të dhënave të 24 orëve paraprake, po ashtu janë shëruar 1,710 pacientë. Ndërkaq, raste aktive me koronavirus janë 9,461. Sa i përket vaksinimit, në 24 orët paraprake janë administruar 1,427 doza të vaksinës. Deri më tani, në Kosovë me

dy doza të vaksinës janë imunizuar 811,331 persona. Të drejtë vaksinimi kanë të gjithë personat nga moshë 12-vjeçare. Ndërkaq, dozën e tretë dhe atë përforcuese mund ta marrin të gjithë personat që para tre muajsh janë imunizuar me dy dozat e vaksinës kundër koronavirusit.



Kryetari i Gjilanit premtom transparencë të plotë në konkurset e arsimit

GJILAN, 15 SHKURT (ER) - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka pritur të martën në takim zëvendësministrin e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Dukagjin Pupovci. Pasi e ka falënderuar për vizitën, kryetari Hyseni ka thënë se do të ketë transparencë

të plotë në konkurset e arsimit në Gjilan, ndërkaq ka theksuar nevojën e rritjes së nivelit të bashkëpunimit në mes të bizneseve dhe universiteteve për punën e praktike të studentëve.

Zëvendësministri i Arsimit, Dukagjin Pupovci, e ka

falënderuar kryetarin Hyseni për pritjen dhe ka konfirmuar bashkëpunimin e mirë në mes të MASHT-it dhe komunës së Gjilanit, derisa ka konfirmuar edhe implementimin e projektit të veçantë për rekrutimin e mësimit për rritjen e nivelit të arsimit.



Totaj nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Concordia



PRIZREN, 15 SHKURT (ER) - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me "Concordia Projekte Sociale", organizatë joqeveritare që ofron shërbime sociale, arsimore dhe argëtuese për fëmijë, të rinj dhe familje në Qendrën Transit Concordia. "Concordia Projekte Sociale" gjatë këtij viti planifikon t'i zgjerojë shërbimet

e saj duke ofruar shërbime socio-psikologjike për fëmijë dhe familje vulnerabël që nuk mund ta vizitojnë rregullisht Qendrën e Transittit. Këto shërbime do të ofrohen me anë të ekipeve mobile", ka thënë Totaj, duke falënderuar drejtoreshën ekzekutive të organizatës, Mirela Lavric, për gatishmërinë e bashkëpunimit. "Unë si kryetar i komunës së

Prizrenit së bashku me institucionet përkatëse për çështje sociale brenda komunës do të bashkëpunojmë me 'Concordia Projekte Sociale' për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave sociale në komunën e Prizrenit, për t'u mundësuar atyre që kanë nevojë të përfitojnë nga aktivitetet dhe shërbimet e kësaj organizate", ka thënë Totaj.

Fillon riparimi i rrugës "Adem Jashari" në Malishevë

MALISHEVË, 15 SHKURT (ER) - Në kuadër të programit të mirëmbajtjes dhe riparimit të rrugëve në komunën e Malishevës, ka filluar riparimi i rrugës "Adem Jashari" në Malishevë, e cila është një nga rrugët kryesore të qytetit. Fillimin e punimeve në këtë rrugë e kanë parë nga afër nënkryetari i komunës së Malishevës, Vesel Krasniqi dhe drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Avdi Morina. Nënkryetari Krasniqi është shprehur i kënaqur me fillimin e punimeve në këtë rrugë, pasi është një prej rrugëve më të

ngarkuara, sepse është rrugë kryesore dhe shërben për hyrje-dalje në qytet nga pjesa veriore, ndërsa mirëmbajtja e saj është tepër e nevojshme për shkak të rëndësisë që ka rruga. Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Avdi Morina, ka sqaruar se riparimi i kësaj rruge bëhet në kuadër të programit komunal për mirëmbajtjen e rrugëve dhe është pjesë e projektit për riparimin e 19 500 metrave rrugë në qytet, përfshirë edhe rrugën "Adem Jashari" dhe mundësohet nga buxheti i komunës së Malishevës.



Lirimi i hapësirave publike mbetet prioritet i Drejtorisë së Inspeksionit në Mitrovicë



MITROVICË, 15 SHKURT (ER) - Drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit në Mitrovicë, Valon Brahimi, i shoqëruar nga drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, Granit Tmava, si dhe drejtori i Administratës, Gëzim Stavileci, kanë qëndruar për vizitë në objektin e shoqatës "Down Syndrome Kosova" në

Mitrovicë. Kjo vizitë është realizuar pas disa shqetësimeve të ngritura nga vetë qytetarët për pengesa dhe vështirësi të lëvizjes përgjatë trotuareve në disa lagje të qytetit. Me këtë rast, drejtori Brahimi ka theksuar se në kuadër të aksioneve të Drejtorisë së Inspeksionit për lirim të hapësirave publike të qytetit,

institucionet komunale do t'i ndërmarrin veprimet e duhura që të bëhet lirim i trotuareve, respektivisht të bëhet zhvendosja e rrethojës tek objekti i shoqatës "Down Syndrome Kosova" në Mitrovicë, në mënyrë që qytetarëve mos t'u rrezikohet jeta nga aksidentet e ndryshme të trafikut.

Latifi: KFOR-i ka luajtur rol jashtëzakonisht të mirë në sigurinë e qytetarëve

RAHOVEC, 15 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka pritur të martën në takim komandantin e KFOR-it të Rajonit Perëndimor të Kosovës, kolonel Marco Javarone, me bashkëpunëtorë, si dhe përfaqësues të LMT në Rahovec. Në fokus të takimit kanë qenë çështjet që kanë të

bëjnë me sigurinë si dhe komplikimet që solli pandemia në mirëqenien ekonomike dhe sociale të qytetarëve. "Komandantin e KFOR-it, Javarone, e falënderova veçanërisht për donacionin e fundit, ku mundësohet sigurimi i energjisë alternative përmes paneleve solare për palestrën e

qytetit 'Mizahir Isma', por edhe për kontributet e tjera të cilat janë të vazhdueshme. KFOR-i ka luajtur rol jashtëzakonisht të mirë në mirëqenien dhe sigurinë e qytetarëve të Republikës së Kosovës, prandaj dera jonë do të jetë përherë e hapur për secilin pjesëtar të këtij misioni ushtarak në vendin tonë", ka thënë kryetari Latifi.



Kryetari i Ferizajt viziton objektin e djegur të 'Viva Fresh Store'-s

FERIZAJ, 15 SHKURT (ER) - Kryetari i komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka reaguar të martën pas djegies së objektit të "Viva Fresh Store" në këtë qytet. Ai ka dalë në vendin e ngjarjes për t'i parë nga afër dëmet e shkaktuara. "Të gjithë u zgjuam sot me tronditjen që shkaktoi fatkeqësia e zjarrit,

me dëme shkatërrimtare në 'Viva Fresh Store' në Ferizaj. Sot në mëngjes dolëm bashkë me drejtorin e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Arben Halili, drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Policisë në Ferizaj, Basri Shabani, Luan Salihun nga Brigada e Zjarrfikësve në Ferizaj, për t'i

parë nga afër dëmet dhe përgëzuar ekipet e zjarrfikjes që bënë maksimumin për t'i minimizuar dëmet materiale. Fatmirësisht, nuk ka asnjë dëm në njerëz, gjersa për dëmet materiale dhe shkaktimin e zjarrit, fjalën e kanë organet përgjegjëse shtetërore", ka thënë Aliu.



Në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në FSK fillon dhurimi i gjakut

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 SHKURT - Me aktivitetin koordinues të shërbimit mjekësor të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), në kuadër të bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Mbrojtjes me Qendrën Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut (QKKTGJ), të martën në Ministri të Mbrojtjes ka filluar aksioni i dhurimit vullnetar të gjakut. Personeli i Ministrisë së Mbrojtjes edhe këtë herë i është përgjigjur pa hezitim këtij aksioni, në mesin e të cilëve edhe ministri i

Mbrojtjes, Armend Mehaj, si dhurues i rregullt vullnetar i gjakut, si dhe zëvendëssekretari i përgjithshëm, Salvador Elmazi. Këtë radhë aksionin e bëri shumë të veçantë dhurimi i gjakut nga këshilltari amerikan i ministrit të Mbrojtjes, Tom Niblock, i cili përfaqëson vlerat e tij të larta humane krahas partneritetit tonë të ngushtë me miqtë tanë amerikanë. Edhe pse në rrethana pandemie, vllugun e aktiviteteve dhe fazës së vaksinimit në ditën e parë të aksionit u grumbulluan doza të konsiderueshme të gjakut, që nga punëtorët e QKKTGJ-së u shpreh

vlerësim i lartë për gatishmërinë e treguar.

Aksioni i dhurimit vullnetar të gjakut do të vazhdojë edhe në ditët në vijim nëpër të gjitha kazermet e FSK-së.

Aksioni vullnetar i dhurimit të gjakut është aktivitet i planifikuar në Ministri të Mbrojtjes dhe FSK dhe për shumë vite tradicionalisht mbahet dy herë në vit.

Përveç gjatë aksionit të organizuar, pjesëtarët e FSK-së kanë qenë dhe janë çdoherë të gatshëm t'u përgjigjen kërkesave të QKKTGJ-së edhe për nevojat sporadike në raste specifike.

Presidentja kërkon mbështetjen e shtetit holandez për vizat

PRISHTINË, 15 SHKURT (ER) - Presidentja Vjosa Osmani ka pritur të martën në takim ambasadorin holandez në Kosovë, Carin Lobbezoo. Presidencën ka njoftuar se në takim është diskutuar për situatën e përgjithshme në vend, për përballjen me pandeminë dhe për mundësitë e shtimit të bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve. Presidentja Osmani ka përsëritur se Kosova tashmë ka plotësuar kriteret për liberalizimin e vizave, ndaj në këtë kontekst ka shfaqur shpresën se do ta ketë mbështetjen e shtetit holandez. Sipas presidentes Osmani, është radha që BE-ja ta mbajë fjalën kundrejt qytetarëve të Kosovës sa i përket liberalizimit


të vizave.

U diskutua edhe për zhvillimet në rajon dhe për nevojën e integritetit të shteteve të rajonit të Ballkanit në BE.

Presidentja Osmani dhe ambasadorja Loobezoo diskutuan edhe për bashkëpunimin politik dhe ekonomik ndërmjet Holandës dhe Kosovës.

Presidentja Osmani ka potencuar se Kosova ka bërë hapa përmbajtësor në sundimin e ligjit dhe krijimin e mjedisit të përshtatshëm për investitorët e huaj.

Në fund të takimit ambasadorja Loobezoo ia ka dorëzuar presidentes Osmani telegramin e urimit të mbretit të Holandës, Willem-Alexander R., për 14-vjetorin e pavarësisë së Kosovës.



Pjesëtarët e FSK-së lirohen nga pagesa e udhëtimit me transportin urban në Prishtinë

PRISHTINË, 15 SHKURT (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka njoftuar se bashkëpunimi me komunën e Prishtinës ka filluar me vendimin për lirim nga pagesa e udhëtimit të ushtarakëve të FSK-së me transportin urban. "Me qëllim të mbështetjes së

ushtarakëve të FSK-së dhe lehtësimin në funksionalitetin institucional të FSK-së, kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka nënshkruar vendimin për lirim nga pagesa e udhëtimit të ushtarakëve të FSK-së nga pagesa e udhëtimit me sistemin e transportit urban

që menaxhohet nga komuna e Prishtinës", ka bërë me dije Mehaj. Ai ka treguar se, po ashtu, u pajtuan që, pas një analize dhe vlerësimi nga të dyja palët në të ardhmen, të arrihet edhe një memorandum bashkëpunimi në fusha të tjera të interesit të përbashkët.



Hajdari: Ligji për Investimet Strategjike do të ofrojë qasje të unifikuar për të bërit biznes në Kosovë

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 12 SHKURT - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka mbajtur një tryezë diskutimi me hisedarë nga institucionet shtetërore dhe sektori privat për të diskutuar rreth fuqizimit të dialogimit në mes të sektorit publik dhe privat dhe prioriteteve për vitin 2022. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka thënë se programi i qeverisë përfshin objektiva të ministrisë që ajo udhëheq, si rritja e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve vendore duke pasur parasysh se vendi ynë është furnizues alternativ për investitorët e huaj, rritja e infrastrukturës së cilësisë, zhvillimi i qëndrueshëm përmes turizmit, inovacioni dhe ndërmarrësia si një sistem i

brishtë i trashëguar dhe përkrahja dhe nxitja e bizneseve të cilët kanë për synim investimin.

Ministria Hajdari është shprehur se pa ndihmën e sektorit privat këto objektiva nuk do të mund të realizohen, në veçanti Ligji për Investimet Strategjike dhe të Huaja, duke theksuar se ky ligj do të ofrojë një qasje të unifikuar të bërit biznes në Kosovë, por edhe për të krijuar barazi për të gjithë investitorët vendorë. "Duhet theksuar në veçanti investimet strategjike dhe të huaja të cilat do të jenë të përfshira në një ligj të vetëm dhe do ta ofrojnë mundësinë e negociimit të drejtpërdrejt me qeverinë", ka deklaruar Hajdari. Getoar Mjeku, zëvendësministër i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, i ka inkurajuar të gjithë pjesëmarrësit të kontribuojnë me komente në udhëzimet administrative, duke



thënë se kontributi i sektorit privat u ndihmon shumë institucioneve në vendimmarrje.

Pjesëmarrësit nga sektori privat theksuan disa nga shqetësimet e tyre të cilat ndërlidhen me zonat

industriale, zonat doganore dhe lehtësimin e financimit të eksportit.

Ministria e Bujqësisë mbulon 75 për qind të vlerës së primit për sigurimet bujqësore

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 15 SHKURT - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural përmes programit të pagesave direkte gjatë vitit 2022 do t'i mbështesë fermerët për subvencionimin e primit të sigurimit bujqësor "indeks", të cilët kultivojnë

kulturën e mollës, qershisë, misrit, fasules, dardhës, specave, kumbullës, mjedrës, vishnjës, dredhëzës, arrës, rrushit, si dhe primin e sigurimit tradicional bujqësor për kulturën e mollës - pemishte intensive, specit - kultivimi intensiv, si dhe rrushit të verës.

MBPZHR-ja ka njoftuar se planifikon që programin e

pagesave direkte për vitin 2022 ta aprovonë në fund të muajit mars dhe me qëllim që fermerët të jenë të përgatitur për mënyrat dhe format e përkrahjes në kuadër të skemës së primit të sigurimit bujqësor i njofton të gjithë ata që i plotësojnë kriteret për subvencionim se mund të bëjnë blerjen e polisës së sigurimit bujqësor indeks dhe

tradicional. "Blerja e këtyre polisave duhet të bëhet sipas kushteve të përcaktuara në dokumentet e produkteve të lartpërmendura, sipas kushteve specifike të secilit produkt për llojin e sigurimit bujqësor të aprovuar nga MBPZHR-ja dhe sipas njoftimit që u është bërë kompanive të sigurimit, të cilat do të vazhdojnë të ofrojnë

shitjen e polisave të sigurimit bujqësor", ka njoftuar MBPZHR-ja.

MBPZHR-ja ka theksuar se përmes politikave të duhura bujqësore në kuadër të programit të pagesave direkte dhe njoftimeve me kohë për këto skema mbështetëse, synon realizimin sa më efektiv të masave mbështetëse për këtë vit.



Mbahet ankandi i dytë i letrave me vlerë për vitin 2022

PRISHTINË, 15 SHKURT (ER) - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve njofton se më 22 shkurt do të mbahet ankandi i dytë për vitin 2022 i letrave me vlerë. Në këtë ankand do të emetohen obligacione me maturitet dhjetëvjeçar në

shumën prej 15 milionë eurosh. "Investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për Borxhin Publik, ku interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen (10 vjet) dhe është tërësisht i liruar nga tatimi",

thuhet në njoftimin e Ministrisë së Financave. Kjo ministri thotë se për detaje rreth pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë duhet të kontaktohet ndonjëherë nga bankat komerciale që operojnë në Kosovë.



Arsyet e krizës që mund të sjellë luftën

Çfarë ndodhi mes Rusisë dhe Ukrainës, pse arritëm në këtë pikë?
Dhe pse Putini do të donte të pushtonte vendin?



Kriza midis Ukrainës dhe Rusisë, pavarësisht disa përpjekjeve diplomatike, ka arritur një nivel veçanërisht të lartë tensioni. Por cilat janë shkaqet e kësaj krize? Cila është rrënja e një lufte që – për disa vëzhgues – tashmë ka filluar?

Cila është origjina e konfliktit midis Rusisë dhe Ukrainës?

Në shkurt të vitit 2014, populli ukrainas rrëzoi presidentin pro-rus Viktor Janukoviç, duke krijuar një qeveri të përkohshme pro-evropiane që nuk njihet nga Moska. Vladimir Putin u përgjigj duke aneksuar Krimenë dhe duke inkurajuar revoltën e separatistëve pro-rusë në Donbass, një rajon në juglindje të vendit.

Sot brezat e rinj po e shtyjnë Ukrainën drejt Evropës dhe presidenti aktual Volodymyr Zelensky – i zgjedhur në vitin 2019 – është gjithashtu i afërt me Perëndimin.

Konflikti, megjithatë, ka rrënjë më të lashta dhe më të thella.

Presidenti rus beson se vendi i tij ka një “të drejtë historike” mbi Ukrainën, e cila ishte pjesë e Bashkimit Sovjetik deri në shpërbërjen e tij në vitin 1991: ai gjithashtu shkroi hapur në një artikull të gjatë të botuar vitin e kaluar, në të cilin e përcaktoi Rusinë dhe Ukrainën “një komb”.

Rënia e Bashkimit Sovjetik la gjithashtu plagë të thella te një pjesë e popullit rus: vetë Putini e kishte quajtur atë “katastrofa më e madhe gjeopolitike” dhe Ukraina ishte humbja më e dhimbshme.

Shumë, shkruan David Sanger në New York Times, besojnë se Putini tani e konsideron veten “në një mision për të korrigjuar këtë gabim”. Ukraina gjithashtu ndan një kufi prej 2200 kilometrash me Rusinë.

Çfarë lidhje ka NATO me gjithë këtë?

Që nga viti 2008 – para ardhjes së qeverisë pro-evropiane të pa njohur nga Putin -, pas samitit të Bukureshtit, Ukraina po punonte për t’u bashkuar me

NATO-n, por Aleanca Atlantike nuk mund të pranojë anëtarë të rinj, të përfshirë tashmë në konflikte.

Pra, Kievi duhet të luftojë korrupsionin që mbizotëron në vend dhe të ndërmarrë një rrugë reformash politike dhe ushtarake. Prandaj, në këtë moment, një hyrje në NATO ka shumë pak gjasa, edhe për shkak të “peshës” së pozicionit të Rusisë: për Putinin, hyrja e Ukrainës në Aleancën Atlantike do të ishte pika pa kthim. (Për NATO-n, natyrisht, Rusia nuk ka fuqi formale të vetos).

Ukraina, nga ana tjetër, po kërkon një afat kohor të saktë për t’u bashkuar me Aleancën Atlantike. Edhe presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, në mënyrë indirekte i është përgjigjur kësaj pyetjeje: “Mundësia e anëtarësimit të Ukrainës në NATO në një afat të shkurtër është shumë e largët”, tha presidenti amerikan.

Ndërkohë, ndërhyrja ruse ka ripërtërirë gjithashtu ambicet e vendeve si Finlanda dhe Suedia, të cilat Moska do të donte t’i mbante

jashtë Traktatit të Atlantikut të Veriut.

Pse Rusia ka frikë nga zgjerimi i NATO-s?

Aktualisht, vetëm 6% e kufijve të Rusisë prekin vendet e NATO-s, sipas Departamentit Amerikan të Shtetit.

Kremlini dëshiron mbi të gjitha të ruajë sferën e tij të ndikimit në zonë dhe dëshiron që NATO të heqë dorë nga aktivitetet e saj në Evropën Lindore, duke u kthyer në situatën e vitit 1997: që atëherë janë bërë anëtarë të Aleancës Atlantike Republika Çeke, Hungaria, Polonia, Bullgaria, Estonia, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Shqipëria, Kroacia, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut.

Kjo do të thotë se NATO-s do t’i duhet të tërheqë trupat e saj nga Polonia dhe tre republikat baltike, si dhe raketat e saj nga Polonia dhe Rumania. Moska akuzon NATO-n për mbushjen e Ukrainës me armë dhe Shtetet e Bashkuara për nxitje të tensioneve.

Putin thotë se nuk do të pushtojë Ukrainën: a është e besueshme?

Faktet tregojnë për një situatë tjetër: më së shumti vendosja masive e ushtarëve përgjatë kufirit, mbështetja për separatistët e Donbasit – të cilët janë pajisur me gjysmë milioni pasaporta ruse – dhe kërcënimi i pasojave të rënda nëse Ukraina do të bënte diçka provokuese.

Putini gjithashtu ka sulmuar tashmë Çeçeninë në vitin 1999, Gjeorgjinë në 2008, vetë Ukrainën në 2014 dhe Sirinë në 2015. Siç vëren Henry Foy në Financial Times, megjithatë, një qasje mjaft e pazakontë ndaj diplomacisë moderne po ndodh: Shtëpia e Bardhë, NATO dhe Bashkimi Evropian po shpërndajnë një sasi të madhe informata, informacione inteligjente, kërcënime dhe akuzat e llojeve të ndryshme – materiale zakonisht të rezervuara për negociatë – për të shmangur një luftë.

E gjithë kjo, sqaron korrespondenti në Bruksel i së përditshmes britanike, ka ekspozuar para publikut botëror çarjet e frontit perëndimor, mbi mënyrën se si të sillet me Rusinë.

4 VJET PA ABDILHAQIM ADEMIN BESNIKUN E ALI AHMETIT



Ismet SYLEJMANI

Të rrallë janë bijtë e mëdhenj të popullit tonë, edhe më të rrallë janë shokët e bashkëluftëtarët besnik të çështjes kombëtare dhe të udhëheqësve kombëtarë! Abdilhaqim Ademi, ishte njëri prej shokëve e bashkëveprimtarëve më të ngushtë e më të afërt të shokut

tim, Komandantit të Pergjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, Kryetarit të BDI-së, Udhëheqësit karizmatik të popullit shqiptar Ali Ahmeti! Kontributi i madh i Abdilhaqimit dhënë luftës për liri e dinjitet të popullit shqiptar në Maqedoninë e Veriut, ishte dhe mbetet i madh dhe i pamohueshëm! Gjithashtu angazhimi i

Abdilhaqimit, ishte i pazëvendësueshëm në konsolidimin e shtetit të Maqedonisë pas vitit 2001 dhe do të mbetet thesar i madh dhe me vlerë të pamatshme! Figurat sikur Abdilhaqim Ademi, janë të rralla dhe prandaj ata janë të pavdekshëm! Historia do ta shkruaj emrin e Abdilhaqim Ademit me shkronja të arta!

Abdilhaqim Ademi do të mbahet gjatë në mendje dhe do të kujtohet gjithmonë me nderim e respekt të madh! Abdilhaqim Ademi është i pari dhe i prinë listës së shokëve më besnik e të panënshtuar të Udhëheqësit të madh të popullit shqiptar Ali Ahmeti! Lavdi e nderim i përjetshëm, të pavdekshmit Abdilhaqim Ademi!
Prishtinë, 15 Shkurt 2022

PS: Fotoja është e datës 21 Nëntor të vitit 2015, në ambientet e Hotel Epinal në Manastir! Në foto është i ndjeri Abdilhaqim Ademi, atëherë Minister i Arsimit dhe Shkencës të Maqedonisë së Veriut, Znj. Lindita Nikolla, ish-Ministre e Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë, aktualisht Kryetare e Parlamentit të Shqipërisë dhe autori i shkrimit Ismet Sylejmani!

Fan Noli për Shqipërinë, vend ku mbretëron konfuzioni i pesë anarkive

Pjesë nga fjalimi i mbajtur në Parlamentin e Shqipërisë në vitin 1924.


Në vendin tonë mbretëron konfuzioni i të pesë anarkive:

E para, anarkia fetare: katër fe të ndryshme, që s'kanë zënë rrënjë në zemrën e një populli pagan. E dyta, anarkia sociale: këtu s'ka as klasë bejlerësh, as klasë bujqësh, as klasë burxhoazie. Këtu bujku është më bej se beu, beu më bujk se bujku. Kini një shembull të bukur në Partinë Popullore, e cila mbahet sot në fuqi prej bejlerëve dhe oxhakët më të vjetër, kur anëtarët e kësaj

partie lëvdohen që kanë shpëtuar prej bejlerëve.

E treta, anarkia morale: këtu qeni s'njeh të zotin; këtu karakteret lopësohen, qulloshen dhe ndërrojnë forma dita-ditën si në kaleidoskop. Këtu ambiciet janë pa fre e pa kufi. Këtu i padituri i di të gjitha dhe i pazoti është i zoti për të gjitha.

E katërta, anarkia patriotike: këtu brenda në një ditë, si me magji, tradhtari bëhet patriot dhe patrioti tradhtar. Këtu shohim përpara syve tanë të kapardisen si patriotë të mëdhenj, ata që kanë luftuar për "harfet" e për flamurin e babës, që kanë djegur Shqipërinë



e Mesme ose ata që janë puthur me andartët e i kanë ndihmuar për të shkretuar anembanë Toskerinë; këtu, si më thoshte një mik, është më mirë të jetë njeriu tradhtar e të shikojë interesin e tij e të jetë i sigurt që të nesërmen do të proklamohet patriot i madh.

E pesta, anarkia e idealeve: këtu idealet janë të errëta, të shtrembëruara e të modifikuara të Fanarit e të Buharës përfyten e për, lëshen në një luftë për vdekje me idealet e gjalla, elegante dhe të ndritshme të Perëndimit; na mungojnë vetëm idealet e antropofagëve.

Po për të zënë vendin e tyre kemi kolltukofagët, krimba të verdhë me kokë të zezë, që rriten me plagët e infektuara të Shqipërisë në lëngim, këpushë, që mund t'i copëtosh, po jo t'i ç'qitësh nga trupi që ka, fshojnë e thëthijnë. Herodoti na tregon se në be, tejjën navale të Selaminës, një athenian

kapi një anije persiane me dorën e djathtë e s'e lëshonte gjersa ia pr, enë; ahëre e kapi me dorën e dorën e mëngjër; ia prenë edhe këtë; ahëre e kapi me dhëmbë dhe s'e lëshoi gjersa i pr, enë kokën.

Sikur të ngjallej Herodoti përsëri do të shikonte që kolltukofagët tanë janë më të fortë se ky trim legjendar i vjetërsisë greke. Që t'i ç'qitësh këta tanët nga kolltuku duhet t'u preç jo vetëm duart e kokën, po dhe këmbët e trupin..." Pjesë nga fjalimi i mbajtur në Parlamentin e Shqipërisë në vitin 1924 por që tingëllon njësoj aktual edhe sot.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Interi sfidon gjashtë herë kampionët e Evropës

Interi sonte (e mërkurë) e pret skuadrën e Liverpoolit me synim që të mposhtë dhe të bëjë hapin e parë drejt kalimit në çerekfinale. "Reds" në anën tjetër do të mundohen të marrin rezultat pozitiv para ndeshjes kthyesë në Angli. Nga ora 21:00 zhvillohet edhe ndeshja tjetër mes Salzburgut dhe Bayern Munchen

"Epoka e re"

MILANO, 15 SHKURT - Përballje e "zjarret" do të zhvillohet sonte (e mërkurë) në Ligën e Kampionëve mes kampionës së Italisë, Inter dhe Liverpoolit. Ndeshja që zhvillohet në "San Siro" është e para e 1/16 mes këtyre skuadrave. "Reds" ishin një nga tri skuadrat e këtij kompeticioni që përfunduan fazën e grupeve me një rekord të qind për qind, kurse "nerazzurri" përfunduan në vendin e dytë pas Real Madridit. Trajneri i Interit, Simone Inzaghi e ka pranuar se Liverpooli është favorit në letër, por beson se diferencën e bënë vendosmëria. Trajneri italian e ka lavdëruar skuadrën e drejtuar nga Jurgen Klopp, duke thënë se është ndër më të mirat në Evropë. "Mendoj se klubet



angleze janë shumë të forta, të gjitha kanë dalë të parat të grupe përveç Chelseat. Liverpooli është një nga skuadrat më të mira në Evropë, por djemtë tanë i meritojnë këto lloj ndeshjesh. Nuk kemi luajtur në raundin e 16 për shumë vite dhe megjithëse do të jetë e vështirë, do

përpiqemi t'ia dalim. Në letër Liverpooli është favorit, por ndeshjet duhet të luhen. Unë do u kërkoj djemve të dalin në fushë dhe të luajnë lirshëm, për të treguar idetë tona. Vendosmëria do të bëjë diferencën", ka thënë Inzaghi. Interi në këtë ndeshje do jetë pa Joaquin Correan dhe

Formacionet e mundshme:

Inter: Handanović; Skriniar, De Vrij, Bastoni; Dumfries, Vidal, Brozović, Calhanoglu, Perisic; Martinez, Dzeko.
Liverpooli: Alisson; Alexander-Arnold, Matip, Van Dijk, Robertson; Henderson, Fabinho, Thiago; Salah, Jota, Mane.

Të mërkurën takohen:

21:00 Salzburg - Bayern Munchen
21:00 Inter - Liverpool

Robin Gosens të lënduar, kurse Nicolò Barella është i pezulluar pas shkarkimit ndaj Real Madridit në ndeshjen e fundit të grupit. Në anën tjetër Liverpooli nuk ka telashe me mungesa. Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp duke folur për ndeshjen ndaj kampionëve të Italisë, ka thënë se është një ndeshje shumë e vështirë. "Nëse do të arrijmë të dominojmë, do të jetë mirë. Interi do të mbrohet në mënyrë kompakte, do të luajmë kundër një ekipi shumë të fortë, më i miri në Itali. 'Zikaltrit' janë ekip më i fortë se vjet, më të disiplinuar dhe të përgatitur mirë. Do të përballemi me një ekip të jashtëzakonshëm dhe do

të duhet të luajmë një ndeshje të jashtëzakonshme. Liverpooli favorit ngaqë i fitoi të gjitha ndeshjet e fazës së grupit? Historikisht, rezultatet e grupit nuk vlejnë për asgjë... Kuptohet, ishte bukur t'i fitonim të gjitha, nuk e mendoja se ishte e mundur. Megjithatë, është e kaluara. Do të duhet të përdorim përvojën tonë, e dimë që jemi ekip i fortë, por vlerësojmë edhe Interin. Do të jetë një ndeshje e vështirë", ka deklaruar Klopp. Sonte zhvillohet edhe ndeshja tjetër mes Salzburgut dhe Bayern Munchen, e cila për gjermanët duket e lehtë në letër. Të dyja këto ndeshje të Ligës së Kampionëve fillojnë nga ora 21:00.

Sot përballja Drita - Peja

PRISHTINË, 15 SHKURT - Pas spektaklit të Kupës së Kosovës në basketboll, garat vazhdojnë me Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll, ku zhvillohet xhironja e 20. Sfidat e parë do të zhvillohet në mes të Dritës dhe Pejës, takim që zhvillohet të mërkurën në "Karagaçi". Pejanët shihen favoritë, pasi në elitë kanë 11 fitore dhe



shtatë humbje, ndërsa gjilanasit kanë 19 humbje në 19 ndeshje të

zhvilluara, duke qenë skuadra e vetme në elitë pa fitore. Të premten zhvillohen dy përballje të tjera, që janë më interesante. Trepça, pasi e fitoi Kupën pas dhjetë vjetësh, është motivuar maksimalisht dhe përballlet me rivalen e vjetër, Sigal Prishtinën. Mitrovicasit kanë 13 fitore e gjashtë humbje, ndërkohë prishtinasit

kanë dhjetë fitore e nëntë humbje. Ndërkohë, sfida tjetër zhvillohet mes dy skuadrave prizrenase, Prizreni 16 dhe Bashkimi. Kjo sfidë vjen pas asaj të Kupës, ku fitore kishte shënuar skuadra e Bashkimit. Në elitë Prizreni 16 ka 11 fitore e gjashtë humbje, ndërsa Bashkimi ka tetë fitore dhe 11 humbje.

SUPERLIGA - Java 20

Të mërkurë takohen:
17:00 Drita-Peja

Të premten takohen:
17:00 Trepça-Sigal Prishtina
19:00 Prizreni 16-Bashkimi

Sfida interesante në Ligën Unike

PRISHTINË, 15 SHKURT - Në mesjavë do të zhvillohet xhironja e shtatë në Ligën Unike të femrave. Takimi i parë zhvillohet në mes të Bashkimit dhe Tiranës. Skuadra prizrenase ditë më parë fitoi Kupën e Kosovës, duke qenë në maksimum e motivuar dhe kërkon suksese të tjera, ndërkohë që vashat tiranase kanë pesë



humbje në pesë ndeshje të zhvilluara, ndërsa vashat

prizrenase kanë tri fitore dhe tri humbje. Të mërkurën zhvillohet përballja shqiptare në Ligën Unike në mes të Flamurtarit dhe Partizanit. Skuadra nga Vloca është në vendin e dytë në renditje me katër fitore e një humbje, kurse skuadra nga kryeqyteti shqiptar ka një fitore dhe pesë humbje. Ndeshja e fundit zhvillohet mes dy

Liga Unike e femrave - Xhiro 7

Të mërkurën takohen:
17:00 Bashkimi - Tirana
19:00 Flamurtari - Partizani

Të enjten takohen:
17:00 Penza - Prishtina

skuadrave nga Kosova, Penza dhe Prishtina. Kampionet e Kosovës janë lidere me pesë fitore në po aq ndeshje të zhvilluara, kurse vashat prishtinase kanë tri fitore dhe dy humbje. Përballja pritet të jetë shumë interesante mes dy skuadrave që kanë rivalitet të madh, ndërsa kanë synime të fitojnë këtë ligë.

Ademi: Këtë javë emërohet trajneri i Kosovës

Prishtinë, 15 shkurt - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, në një intervistë për Dukagjinin ka folur rreth trajnerit të ri të Përfaqësueses së Kosovës. Ademi ka paralajmëruar emërimin e trajnerit të ri gjatë kësaj jave. "Është java e fundit, besoj se do ta

përfundojmë këtë çështjen e trajnerit", ka thënë Ademi, i cili ka treguar se cilët janë trajnerët e rrethit të ngushtë. "E kemi bërë një komision bashkë me Komitetin Ekzekutiv që i kemi ndarë pesë emrat e fundit të cilët i kemi konsideruar më të mirët për ne. Janë

gjermanë, zviceranë, francezë, polakë, belgë dhe holandezë", ka thënë Ademi, i cili ndihet i nderuar që kaq shumë emra kanë konkurruar për ta marrë drejtimin e "dardanëve", teksa ka zbuluar se në mesin e tyre nuk kishte aplikuar asnjë shqiptar.



Djokoviqi: Nuk jam kundër vaksinimit, por jam gati të heq dorë nga trofetë për ta respektuar të drejtën time

LONDËR, 15 SHKURT - Në një intervistë për BBC, tenisti serb Novak Djokoviqi ka shpalosur idetë e tij në lidhje me çështjen e vaksinës kundër Covidit. Ai ka konfirmuar se nuk e ka kryer vaksinën dhe se nuk do ta kryejë asnjëherë atë.

Djokoviqi është gati të heq dorë nga trofetë për ta respektuar të drejtën e tij. "Nuk jam një person kundër vaksinimit, por jam gati të heq dorë nga trofetë për të respektuar të drejtën time. Ky është një çmim i lartë për t'u paguar, por gjithnjë kam

mbrojtur të drejtën e zgjedhjes se çfarë do të fus në trupin tim", u shpreh Novak Djokoviqi, numri një në botë për meshkuj. Ai deklaroi se është gati të heq dorë edhe nga Roland Garrosi e Wimbledonin nëse ata do ta bëjnë të

detyrueshme vaksinën për të marrë pjesë. "Trupi im, shëndeti im, është më i rëndësishëm se çdo trofe. Unë nuk jam kundër vaksinës dhe e vlerësoj punën e madhe që bëhet për t'i dhënë fund pandemisë", ka deklaruar Djokoviqi.



Hidhet shorti për garat ndërkombëtare ku garon Kosova

PRISHTINË, 15 SHKURT - Në Freising të Gjermanisë është hedhur shorti për kampionatet evropiane për kategori të reja si dhe shtetet e vogla. Në këtë short kanë qenë pjesëmarrëse edhe sekretarja e përgjithshme e Federatës e Basketbollit të Kosovës, Elvira Dushku, njëkohësisht anëtare e Komisionit të Rinjve në FIBA, si dhe Artina Hasani, menaxhere e ngjarjeve dhe basketbollit 3x3 në FBK. Dushku e hodhi shortin për Kampionatin Evropian për shtete të vogla të meshkujt për Divizionin C për U18 të meshkujt, si dhe U16 për meshkujt, që do të zhvillohet në Kosovë. Në Kampionatin Evropian për shtete të vogla në konkurrencën e femrave, vashat "Dardane" do të garojnë në Grupin A së bashku me Qipron, Andorrën, Norvegjinë dhe Maltën. Kampionati mbahet nga 28 qershori deri më 3 korrik në Qipro. Vashat e Kosovës U20 garojnë në Divizionin B dhe kanë një short shumë të vështirë. Në Grupin C do ta sfidojnë Kroacinë, Rumaninë, Malin e Zi dhe Maqedoninë



Veriore. Kampionati zhvillohet në Shkup nga 9 deri më 17 korrik. Në Evropianin e Divizionit C që do të mbahet në Kosovë do të garojnë tetë shtete që janë ndarë në dy grupe. Kosova U16 e meshkujve do të jetë në grup me Shqipërinë, San Marinon dhe Maltën, kurse në Grupin tjetër janë Andorra, Gjibraltari, Moldavia dhe Armenia. Kampionati zhvillohet nga 12 deri më 17 korrik. Kosova

U18 të meshkujt do të jetë në grup me Holandën, Bosnjë e Hercegovinën, Bullgarinë, Gjeorgjinë dhe Norvegjinë. Garat mbahen në Oradea të Rumanisë nga 29 korriku deri më 7 gusht. Kosova U20 të meshkujt është në grup me Suedinë, Gjeorgjinë, Maqedoninë e Veriut dhe Austrinë. Kampionati mbahet në Tbilisi të Gjeorgjisë nga 15 deri më 24 korrik.

Italia lëshon urdhër arresti ndërkombëtar për Robinhon, i dënuar për dhunimin e një vajze shqiptare

MILANO, 15 SHKURT - Gjykata e Lartë konfirmoi më 19 janar dënimin me nëntë vjet burg për Robinhon, i akuzuar për dhunë seksuale në grup ndaj një gruaje shqiptare 23-vjeçare në vitin 2013, kur braziliani kishte veshur fanellën e Milanit. Pak ditë më vonë Prokuroria Publike e Milanos përgatiti një kërkesë ekstradimi për ish-futbollistin dhe mikun e tij Ricardo Falco, i cili u dënua për të njëjtin krim. Për të dy është lëshuar një urdhër arresti ndërkombëtar. Ish-ylli i Milanit, Robinho, jeton në izolim total dhe, siç raportohet nga "Il Corriere della Sera", duhet të shpësojë që Brazili do të vazhdojë ta mohojë ekstradimin,



sipas Kushtetutës. Edhe Pato dhe ish-shokët e tjerë pretendojnë se klasa e 1984-s është zhdukur nga "radarët" dhe ka mbyllur të gjitha urat me Evropën, duke shkëputur të gjithë numrat e vjetër të telefonit. Përveç fotove të publikuara në rrjetet sociale, nuk

ka më asnjë gjurmë të tij. Ai jeton i mbyllur në vilën bregdetare Guaruja, në shtetin e Sao Paulos, ku bën një jetë normale së bashku me gruan e tij Vivian Guglielmetti dhe tre fëmijët e tyre, të cilët nuk e kanë braktisur pavarësisht prej akuzave të rënda.

Unitedi nuk e lëshon De Gean, largohet Hendersoni

David de Gea me shumë mundësi do ta vazhdojë karrierën të "Djajve e Kuq". Drejtuesit e klubit kanë dalë jashtë politikave të tyre për ta

mbajtur në skuadër spanjollin, pasi më parë kanë ndjekur rregullin që lojtarëve mbi 30 vjeç t'ua ofronin rinovimin për 6 muaj me ulje page, por kjo

nuk do të zbatohet për de Gean, të cilit i kanë ofruar rinovimin deri në vitin 2024 dhe paga e tij nuk do të pësojë ulje (do të vazhdojë të përfitojë 375 000

paundë në javë). Rinovimi i spanjollit e shtyn drejt largimit Dean Henderson, pavarësisht se kontrata e tij përfundon në vitin 2025. 25-vjeçari nuk

dëshiron të qëndrojë më si zëvendësues dhe ofertat ndaj tij nuk mungojnë, kështu që portieri me shumë mundësi do të largohet në verë.

SHKURT

Greza largohet nga Osijeku

Ëros Greza është larguar edhe zyrtarisht nga skuadra e Osijekut. Sulmuesi i Kombëtares dhe klubi kroat kanë ndërprerë në mënyrë konsensuale kontratën. 26-vjeçari ishte i huazuar tek ekipi hungarez i Zalaegerszegis dhe u rikthye sërish te Osijeku pas përfundimit të huazimit por, mesa duket, rrugët e tyre u ndanë aty. Gjatë këtij sezoni me fanellën e skuadrës hungareze ai në kampionat u aktivizua gjithsej në pesë ndeshje nga ku realizoi dhe një gol.

Bale në verë largohet nga Reali

Sulmuesi uellsian Gareth Bale do të largohet nga skuadra e Real Madridit në fund të këtij edicioni. Largimin e Bales në verë e ka konfirmuar edhe trajneri i Realit, italiani Carlo Ancelotti. "Bale dëshiron që këtë sezon ta mbyllë me trofe te Reali, pasi ky është synimi i tij përpara se të largohet", ka thënë Ancelotti.

Bale ishte transferuar te Reali në verën e vitit 2013 nga Tottenhami për 100 milionë euro dhe ka fituar 17 trofe në total, përfshirë katër herë Ligën e Kampionëve. Ai vitet e fundit nuk ka pasur hapësirë të madhe në klub për shkak të lëndimeve dhe sezonin e kaluar ishte i huazuar te Tottenhami. Edhe këtë edicion Bale ka vetëm katër paraqitje dhe një gol të shënuar në të gjitha garat për Real Madridin.

Iniesta: Barça është shtëpia ime

Andres Iniesta e ka hapur derën për kthimin e mundshëm në Barcelonë, pasi e pranoi se ende e vlerëson këtë klub si shtëpinë e vet. Iniesta e gëzoi një karrierë të shkëlqyer në "Camp Nou", e cila zgjati gati dy dekada, duke fituar tituj të shumtë në La Liga dhe në Ligën e Kampionëve. Mesfushori spanjoll luajti rol të kyç në njërin prej skuadrave më të mira të Barçës në histori, përkrah Lionel Messit dhe Xavit, por u largua nga klubi në vitin 2018 për t'iu bashkuar Vissel Kobes në Japoni. Iniesta do t'i mbushë 38 vjet në maj, por nuk e ka ndër mend t'i varë këpucët në gozhdë dhe do ta mirëpriste mundësinë për t'u kthyer në Katalonjë, nëse ajo i vjen. "Do të doja të kthehem në Barcelonë. Do të doja ta ndihmoj institucionin. Ka shumë gjëra të përfshira dhe është e vështirë të dish se çfarë do të ndodhë në të ardhmen. Barça është shtëpia ime dhe askund tjetër nuk mund të jem më mirë se atje. Më pëlqen shumë të mendoj për të luajtur. Kjo gjë më tërheq më së shumti sot", ka thënë Iniesta.

Strakosha ndryshon mendje, gati të rinovoj me Lazion

Thomas Strakosha nuk ka vendosur ende për fatin e tij te Lazio. Sipas së përditshmes italiane "Corriere Dello Sport", çështja e rinovimit të portierit shqiptar nuk është mbyllur përfundimisht. Strakoshës i skadon kontrata me klubin kryeqytetas në qershor, por në periudhën e fundit gjërat kanë ndryshuar. Strakosha ishte titullar në sfidën me Bolognën dhe duke iu referuar së përditshmes italiane, ende nuk ka akord me ndonjë klub tjetër për t'u transferuar në verë me parametër zero. Portieri shqiptar mund të tundohet për të firmosur me garanci ekonomike, por mbi të gjitha teknike. Strakosha kërkon të luajë, jo të qëndrojë në stol. Pak muaj më parë dukej i destinuar për t'u larguar, por tani situata ka ndryshuar.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada-Government
 MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
 AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
 AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
 AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 121/1
 Dt: 15.02.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

SHPLLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendre e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë në Prizren për vitin shkollor 2022/2023

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë	Prishtina	Një(1) mësimdhënës/e për lëndë profesionale të makinerisë me 20 orë mësimore;	Vend i lirë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe procese mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimin e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

Procedurat e konkurrimit:

- Afati i konkurrimit është 15 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë.
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
- Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.
- Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "BEHARII" Sh.p.k. Prizren, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e betonit në vendin e quajtur Fusha-Livadhi Avdylit, Z.K. Zgatar, Komuna e Dragashit

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 09.03.2022 në ora 10:00 në Restaurant "Bjeshka", Guri i zi, Lokacioni: Zaplluxhe, Komuna e Dragashit do të organizohet debat publik nga Kompania "BEHARII" Sh.p.k. Prizren., në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e betonit në vendin e quajtur Fusha-Livadhi Avdylit, Z.K. Zgatar, Komuna e Dragashit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Linku: <https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vcxkxVjVlZ0p1aUo0>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "BEHARII" Sh.p.k. Prizren për Bazë e betonit në vendin e quajtur Fusha-Livadhi Avdylit, Z.K. Zgatar, Komuna e Dragashit

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "KRU-Hidromorava" Sh.A. Gjilan, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për , Impiantin për trajtimin e ujrave të zeza në Z.K. Uglar, Komuna e Gjilanit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 11.03.2021 në ora 11:00 në objektin e K.R.U. Hidromorava sh.a. në Gjilan rr. Vëllëzërit Gërvalla pa nr. do të organizohet debat publik nga Kompania "KRU-Hidromorava" Sh.A. Gjilan në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, për Impiantin për trajtimin e ujrave të zeza në Z.K. Uglar, Komuna e Gjilanit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Platforma ZOOM Linku: :
<https://us05web.zoom.us/j/86054850697?pwd=Q1h2aVJ1SXRNNjB1RjZ2aEVlOXpvdz09>

Pascode :0Yh3QS

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "KRU-Hidromorava" Sh.A. Gjilan, për Impianti për trajtimin e ujrave të zeza në Z.K. Uglar, Komuna e Gjilanit

https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lumë's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► “Çëndrimi” SH.P.K. Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me pronar Ali Thaqi adresa, Kramovik Rahovec, shpall të pavlefshme certifikatën e nr. fiskal: 600049763 si dhe certifikatën e TVSH-së, me nr. 330024779.

► “Newco Babush Agricultural Land” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. unik Identifikues 810547177.

► Besnik Daka shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfm " Ibrahim Fehmiu " Prizren.

► Berina Sylmetaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI -IX shfm " Haziz Tolaj " Prizren.

► Fatmir Shabanaj shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Taulant Lleshi Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Përparim Patoku Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Lumturije Morina Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari" Tregti.

► Bajram Sylmetaj Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari.

► Jeton Lamabegu Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi".

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokalit është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokalit gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

